



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës- Gjakovë

01 Nr. /2023

Datë: 26.01.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 dhe 17 shkronja të Ligjit nr. 03/L040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, nenit 21 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.110/04-29365 të miratuar me datë 28.12.2022, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2023, pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Ndryshimin e Vendimeve për Dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të Pronës së paluajtshme komunale -byfet në shkolla, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika një (1) të vendimit me numër 01-011/01-8186 të datës 31.03.2022, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – byfetë në shkolla.
2. Prona e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-00066-2-002130 në sipërfaqe prej 32.00 m², Zona Kadastrale Gjakovë - Qytet, Byfeja në objektin e SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë”, e përcaktuar në pikën një (1) të vendimit me numër 01-011/01-8186 të datës 31.03.2022, të largohet nga procedura e dhënies në shfrytëzim .
3. Ndryshimi i vendimit bëhet për shkak të kërkesës së Këshillit Drejtues të Shkollës “Zekeria Rexha”, për largimin nga procedura e dhënies në shfrytëzim të byfesë në atë shkollë.
4. Pjesa tjetër e vendimit me numër 01-011/01-8186 të datës 31.03.2022, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale – byfetë në shkolla, mbetet e pandryshuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit



Arbëneshja Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës